



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 806/2 Prot

Tiranë, më 09.11.2021

**V E N D I M**

Nr.136, datë 09.11.2021

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit nr. 27 datë 25.08.2021 të Departamentit të Administratës Publike “Për skualifikimin e kandidatës \*\*\*\*\* nga procedura e pranimit në shërbimin civil, kodi # 3587-Lloji i diplomës “Shkenca Inxhinierike/Natyrore”, niveli minimal i diplomës “Master Shkencor” dhe anullimin e aktit të emërimit në shërbimin civil nr.3698 prot., datë 16.06.2021”.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe propozimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me vlerësimin e ligjshmërisë të Vendimit nr. 27 datë 25.08.2021 të Departamentit të Administratës Publike “Për skualifikimin e kandidatës \*\*\*\*\* nga procedura e pranimit në shërbimin civil, kodi # 3587-Lloji i diplomës “Shkenca Inxhinierike/Natyrore”, niveli minimal i diplomës “Master Shkencor” dhe anullimin e aktit të emërimit në shërbimin civil nr. 3698 prot., datë 16.06.2021”.

**Vërej se:**

Konkurrentja \*\*\*\*\* , nëpërmjet një kërkesë të protokolluar me nr. 806 prot., datë 15.09.2021, ka ngritur pretendimin se vendimi nr. 27 datë 25.08.2021 i Departamentit të Administratës Publike, për: “Skualifikimin e kandidatës \*\*\*\*\* nga procedura e pranimit në shërbimin civil, kodi # 3587-Lloji i diplomës “Shkenca Inxhinierike/Natyrore”, niveli minimal i diplomës “Master Shkencor” dhe anullimin e aktit të emërimit në shërbimin civil nr. 3698 prot., datë 16.06.2021” është i padrejtë pasi janë ahkelur kriteret ligjore për vlerësimin objektiv të rrethanave të çështjes.

Mbi bazën e informacionit të mësipërm ka nisur verifikimi i këtij rasti, duke kërkuar sqarimet dhe dokumentacionin e nevojshëm nga Departamenti i Administratës Publike (*nëpërmjet postës elektronike në datën 24.09.2021*), nga përmbajtja e të cilave rezultoi si më poshtë:

Departamenti i Administratës Publike (DAP), në zbatim të neneve 22, 23, 24, 25, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 243 datë 18.03.2015, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, i ndryshuar me VKM nr. 746 dt. 19.12.2018, ka shpallur procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv, për grupin e pozicioneve të shpalljeve me kod #3587 *“Lloji i diplomës “Shkenca Inxhinierike/ Natyrore, niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”*, për tre pozicionet e lira në institucionin Agjencia për Eficiencën e Energjisë, përkatësisht:

- *Specialist në Sektorin e Programeve të Eficiencës dhe Analizës, në Drejtorinë Teknike, në Agjencinë për Eficiencën e Energjisë - Kategoria: IV-a (Shkenca Inxhinierike/Natyrore);*
- *Specialist në Sektorin e Menaxhimit dhe Monitorimit të Projekteve, në Drejtorinë Teknike, në Agjencinë për Eficiencën e Energjisë - Kategoria: IV-a (Shkenca Inxhinierike);*
- *Specialist në Sektorin e Menaxhimit dhe Monitorimit të Projekteve, në Drejtorinë Teknike, në Agjencinë për Eficiencën e Energjisë - Kategoria: IV-a (Shkenca Inxhinierike).*

Pasi ka marrë dijeni për shpalljet e mësipërme, shtetasja \*\*\*\*\* ka aplikuar për grupin e pozicioneve sa më sipër, ku në përfundim të procesit të konkurrimit ka rezultuar e renditur e dyta, në listën e kandidatëve fitues.

Pas përzgjedhjes së pozicionit të punës, sipas renditjes me pikë të kandidatëve, me aktin nr. 3698 prot., datë 16.06.2021, lënda *“Emërim”*, njësia përgjegjëse (DAP) ka emëruar si nëpunës civil në periudhë prove konkurrenten \*\*\*\*\* në pozicionin *“Specialist në Sektorin e Menaxhimit dhe Monitorimit të Projekteve, në Drejtorinë Teknike, në Agjencinë për Eficiencën e Energjisë - Kategoria: IV-a”*, duke shënuar edhe fillimin e marrëdhënieve financiare në këtë institucion.

Pas kësaj, Departamenti i Administratës Publike, në momentin e kryerjes së procesit të hedhjes së të dhënave personale të punonjësve të administratës në Regjistrin Qendror të Personelit, proces i bazuar në nenet 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe Kreun I, pika 2 të Vendimit nr. 833, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave *“Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”*, si dhe nga të dhënat e pasqyruara në regjister nga Bashkia Tiranë, më datë 24.07.2021, ka konstatuar që konkurrentja \*\*\*\*\* ishte e raportuar se ishte larguar nga detyra që ka mbajtur pranë këtij institucioni, me masën

disiplinore të largimit nga shërbimi civil, të parashikuar nga neni 58, gërma “ç”, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Njësia përgjegjëse, e ka verifikuar edhe një herë problemin dhe ka konstatuar që nëpërmjet krahasimit të numrit personal, bëhej fjalë për të njëjtin person. Pas kësaj, është marrë edhe njëherë në shqyrtim dosja elektronike e ngarkuar për të marrë pjesë në procedurën e pranimit në shërbimin civil, me kodin e shpalljes # 3587, nga ku është konstatuar se në librezën e saj të punës, kandidatja nuk kishte të shënuar masën disiplinore “largim nga shërbimi civil”, por figuronte sikur ishte në punë që nga data 08.01.2007, në pozicionin “arkitekte”, pranë Komunes Kashar.

Në këto kushte, DAP i është drejtuar Bashkisë Tiranë me shkresën nr. 4328 prot., datë 27.07.2021, me lëndë “Kërkesë për informacion”, e cila me shkresën nr. 29836/1 prot., datë 05.08.2021, ka kthyer përgjigje duke vënë në dispozicion Vendimin nr. 7279/3 prot., datë 18.05.2020 të Komisionit të Disiplinës, ngritur pranë bashkisë Tiranë, për dhënien e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, ndaj nëpunëses së kësaj bashkie, \*\*\*\*\*.

Nisur nga sa më sipër, është arritur në përfundimin që masa disiplinore e dhënë në datën 18.05.2020, në momentin e kryerjes së konkurrimit ka qenë në fuqi, pasi nuk rezulton të jetë shuar në kuptim të nenit 61, pika 1, gërma “c” të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, apo të jetë anuluar/konstatuar absolutisht e pavlefshme nga gjykata kompetente, përmes një vendimi gjyqësor të formës së prerë (përkundrazi, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur “Rrëzimin e padisë” dhe çështja vazhdon të jete për shqyrtim, në Gjykatën Administrative të Apelit).

Pra, aplikantja \*\*\*\*\* , në periudhën kur ka aplikuar për procedurën e pranimit në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv për grupin e pozicioneve të shpalljeve me kod # 3587 “Lloji i diplomës “Shkenca Inxhinierike/Natyrre, niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”, ka pasur në fuqi masën disiplinore të largimit nga shërbimi civil, por që nuk e ka deklaruar në dosjen e saj të aplikimit.

Në këto kushte në kuptim të nenit 21, gërma “dh”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, aplikantja ka fshehur mosplotësimin e njërit nga kriteret e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil: “ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji”, gjë e cila nëse do të ishte konstatuar më parë, do të sillte si pasojë skualifikimin e menjëhershëm të saj nga procedura e konkurrimit.

Duke qenë para faktit të mësipërm, Departamenti i Administratës Publike si njësi përgjegjëse, me të drejtë ka proceduar me nxjerrjen e Vendimit nr. 27 datë 25.08.2021 të tij “Për skualifikimin e kandidatit \*\*\*\*\* nga procedura e pranimit në shërbimin civil, kodi # 3587-Lloji i diplomës “Shkenca Inxhinierike/Natyrre”, niveli minimal i diplomës “Master

*Shkencor” dhe anullimin e aktit të emërimit në shërbimin civil nr. 3698 prot., datë 16.06.2021”.*

Nisur nga gjithë sa më sipër, do të ishte me vend ti tërhiqet vëmendja njësisë përgjegjëse të Bashkisë Tiranë, e cila nuk ka pasqyruar drejt situatën në dokumentin personal të nëpunëses “*Librezën e Punës*”, duke e dorëzuar atë të paplotësuar dhe krijuar kushte për përfitime të padrejta nga sistemi i shërbimit civil. Lihet detyrë, që të identifikohet nëpunësi përgjegjës dhe nëse do të konstatohet se jemi para veprimeve të kryera me faj, të bëhet objekt analize e të nxirret përgjegjësia disiplinore.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; bazuar në nenin 90, të ligjit nr.44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e ligjshmërisë të vendimit nr. 27 datë 25.08.2021 të Departamentit të Administratës Publike, për “*Skualifikimin e kandidatit \*\*\*\*\**, nga procedura e pranimit në shërbimin civil, kodi # 3587 - Lloji i diplomës “*Shkenca Inxhinierike/Natyrore*”, niveli minimal i diplomës “*Master Shkencor*”; *anullimin e aktit të emërimit në shërbimin civil nr. 3698 prot., datë 16.06.2021*” dhe duke qenë se gjendet i marrë në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohet për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike, Bashkia Tiranë dhe ankuesja \*\*\*\*\*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**

*Punoi: A.Xhaxhiu, Inspektore e KMSHC*

*Pranoi: I.Kukumi, Drejtor i Hetimit dhe Inspektimit Administrativ*

*Miratoi: A. Basha, Drejtore e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes*